





# **PLANI DHE PROGRAMMI I PUNËS PËR VITIN 2024 PËR GJYKATEN THEMELORE NË PRISHTINË**





## Përmbajtja

FJALA E KRYETARES .....	5
PËRMBLEDHJE.....	6
I. Organizimi i punës në Gjykatën Themelor në Prishtinë .....	7
II. Funksionet gjyqësore dhe udhëheqja e Departamenteve - Divizioneve.....	7
Departamenti Special .....	8
Departamenti për Krime të Renda.....	8
Departamenti per të Mitur.....	9
Departamenti Administrativ .....	9
Departamenti i Përgjithshëm.....	10
Për udhëheqës të departamenteve dhe gjyqtar përgjegjës të divizioneve caktohen: .....	12
Perbërja e Kolegjeve, ndarja e lëndëve dhe procedura paraprake .....	13
Procedura paraprake në penale .....	14
III. Degët e Gjykatës .....	15
VII. Orari i Punës dhe Respektimi i Kodit të Mirësjelljes.....	17
X. Implementimi i programit TIK/SMIL.....	19
XI. Transparenca dhe llogaridhënia .....	19
XII. Efikasiteti dhe Prioritizimi i lëndëve brenda sistemit gjyqësor bazuar në Planin Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2023-2025 .....	20

XIII. Komunikimi me Institucionet veprimtaria e të cilave ka ndikim në veprat e gjykatës.....	20
Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i vendeve të punës për stafin administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Degët e saj .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i vendeve të Punës në Degën në Podujevë.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i vendeve të Punës në Degën në Lipjan .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i vendeve të Punës në Degën në Gllogoc.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i vendeve të Punës në Degën në Graçanicë ...	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i vendeve të Punës në Degën në Fushë Kosovë .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Prioritetet e Departamenteve të Gjykatës dhe rekomandimet për vitin 2024 .....	22
Departmenti Special .....	22
Departamenti për Krime të Rënda (DKR) .....	22
Departamenti për të Mitur (DM) .....	23
Departamenti Përgjithshëm/Divizioni Penal ( DP).....	23
Divizioni Civil (DC) .....	24
Divizioni për Kundërvajtje .....	26
Departamenti Administrativ .....	27
Përfundi.....	28

## FJALA E KRYETARES

Kam nderin dhe kënaqësinë të prezantoj Planin e punës për vitin 2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë së bashku me degët e saj.

Ky plani i punës së gjykatës është hartuar në bashkëpunim me gjyqtaret dhe administratën e gjykatës, e që i mundësuan Gjykatës të tejkalojë me sukses sfidat me të cilat po ballafaqohemi si gjykate dhe t'i përbahemi me devotshmëri misionit për zbatimin dhe mbrojtën e sundimit të ligjit e nëpërmes saj të mbrojmë edhe të drejtat dhe liritë e njeriut.

Ne kemi një mision të përbashkët që Gjykata Themelore e Prishtinës të jetë një gjykate e pavarur, e paanshme, e besueshme, profesionale, efikase, e përgjegjshme, llogaridhënëse si dhe transparente.

Plani i punës 2024 paraqet një mundësi shtesë për t'i dhënë drejtim të ri zhvillimit të Gjykatës tone, duke shpalosur ide të reja në përputhje me kërkesat e kohës dhe me rrethanat e reja në punë dhe duke reflektuar mbi sfidat e përballura gjatë vitit paraprak.

Në planin e ri janë përcaktuar prioritetet për vitin e ardhshëm në punën e Gjykatës siç janë rritja e efikasitetit, unifikim i praktikave brenda gjykatës dhe degëve të saj, standardizim në dhënie të shërbimeve dhe procedim i secilës kërkesë sipas një plani kohor duke respektuar renditjen sipas pranimit dhe sipas ligjit; ndershmëri dhe integritet duke kërkuar dhe nxitur gjyqtaret dhe punonjësit tjera të gjykatës që të synojnë standarde të larta të etikes në sjellje dhe në veprimet e tyre; përgjegjshmëri e larte në ushtrimin e funksioneve; profesionalizëm në rritje; reduktim i numrit të lendeve të vjetra; shfrytëzim i burimeve njerëzore aktuale me kapacitet të plotë për rritjen e efikasitetit; rritje e nivelit të sigurisë brenda objektit të gjykatës dhe krijimin e kushteve për çdo person në kuadër të zbatimit të së drejtës.

Pa angazhimin e të gjithëve do të kemi të pamundshëm të arrijmë aty ku synojmë, andaj pres që viti 2024 të jetë vit i efikasitetit dhe pritjes së qytetarëve për marrje të drejtësisë ti takojnë të kaluarës.

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë  
Albina Shabani Rama

## PËRMBLEDHJE

Bazuar në ninen 14 pikat 2.3 të Ligjit për Gjykatat (Ligi 06/L – 054) dhe Rregullores Nr.02/2020 Për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas marrjes së propozimeve në mbledhjen e Kolegjiumit të gjyqtarëve të kësaj gjykate, përcakton Planin e Punës dhe Programin për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve, të gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Themelore në Prishtinë për vitin 2024.

Ky plan i punës është strukturuar në atë mënyrë që të avancoj aktivitetet dhe rezultatet me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të punës së Gjykatës Themelore në Prishtinë si dhe degëve të saj, si në aspektin e organizimit profesional ashtu edhe në atë administrativo teknik, realizimi i të cilave do të bëhet përmes aktiviteteve të arritshme brenda periudhës një vjeçare.

Ky plan program paraqet tërësinë e aktiviteteve që do të zbatohen në vitin 2024, ndër të tjera përcakton: organizimin e punës në Gjykatën Themelore në Prishtinë si dhe degëve të saj, organizimin e punës së administratës gjyqësore, funksionet gjyqësore, emërimin e udhëheqësve të Departamenteve dhe Përgjegjësit e Divizioneve, përbërjen e Kolegjeve, ndarjen e lëndëve gjyqësore, procedurën paraprake, orarin e punës, kodin e mirësjelljes, caktimin e shqyrtimeve gjyqësore dhe publikimi i orarit të mbajtjes së tyre, publikimi i aktgjykimeve, planifikimin e mbledhjeve të kolegjiumit të gjyqtarëve të gjykatës, zbatimin e programit të Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Lëndëve - SMIL, prioritet e departamenteve të gjykatës dhe rekomandimet për departamentet përkatëse etj.

Gjatë këtij viti, gjykimi i çështjeve gjyqësore brenda afateve ligjore, trajtimi i lëndëve të vjetra si dhe lëndëve të kthyera në rigjykim do të jetë një prej prioriteteve kryesore të gjykatës.

## I. Organizimi i punës në Gjykatën Themelor në Prishtinë


Me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, udhëheqë kryetarja e gjykatës. Në mungesë të kryetares me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës udhëheq nën kryetari i gjykatës, për organizimin e punës së Degëve të Gjykatës në Podujeve, Gllogoc, Lipjan, Fushe Kosove dhe Graqnicë, udhëheqin – gjyqtaret mbikëqyrës.

Me menaxhimin e punëve administrative, teknike dhe sigurimit të objekteve, do të administroj administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Për degën e gjykatës ndihmës administratori.

## II. Funksionet gjyqësore dhe udhëheqja e Departamenteve - Divizioneve

Për kryerjen e funksioneve gjyqësore të Gjykatës Themelore në Prishtinë, janë të organizuara gjashtë (6) Departamente:

- Departamenti Special;
- Departamenti për Krime të Rënda;
- Departamenti për të Mitur;
- Departamenti Administrativ,
- Departamenti i Përgjithshëm, në kuadër të së cilët funksionojnë këto Divizionë:
  - Divizioni Penal
  - Divizioni Civil dhe
  - Divizioni për Kundërvajtje



Me qëllim të organizimit më të mirë të punës si dhe zgjidhjen efikase të lëndëve, në kuadër të çdo Departamenti është i caktuar një gjyqtar si Udhëheqës i Departamentit. Ndërsa në krye të çdo divizioni, caktohet një Gjyqtar Përgjegjës që do të organizoj dhe menaxhoi punën e atij divizioni.

Udhëheqësit e Departamenteve dhe përgjegjësit e Divisionit, do t'i raportojnë kryetarit të gjykatës për punën e Departamenteve - Divisionit, së paku njëherë (1) në muaj. Pjesë e raporteve të

udhëheqësit të departamentit dhe përgjegjësit të divizionit, duhet të jenë edhe raportet e gjyqtarëve përgjegjës të divizioneve.

Kryetari i Gjykatës, mund të kërkoj nga udhëheqësit e departamenteve ose gjyqtarëve përgjegjës të divizioneve, që të paraqesin raporte mujore, ose raporte për sezonin e lëndëve të veçanta.

Gjykata Themelore e Prishtinës së bashku me dege ka gjithsej 110 gjyqtar (Kryetarja e Gjykatës dhe 80 gjyqtar në Gjykaten Themelore në Prishtine ndërsa 29 gjyqtar në pese dege te gjykatës)

Gjithsej 107 gjyqtar janë të ngarkuar me lende, pasi që kryetarja e gjykatës nuk ngarkohet me lende, po ashtu 2 gjyqtar nga GJTHP gjenden në studime në SHBA deri në muajin gusht 2024.

## Departamenti Special

Në Departamentin Special<sup>1</sup>, do të punojnë 12 gjyqtarë



1. Valon Kurtaj;
2. Arben Hoti;
3. Musa Konxheli;
4. Valbona Musliu-Selimaj;
5. Mentor Bajraktari;
6. Violeta Namani;
7. Vesel Ismajli;
8. Lutfi Shala;
9. Kujtim Krasniqi;
10. Ngadhnjim Arrni
11. Kushtrim Shyti
12. Rrahman Beqiri

Tre gjyqtaret e fundit do ti bashkohen këtij departamentit me date 01.02.2024.

---

<sup>1</sup> Gjyqtaret janë të caktuar me vendim të KGJK-së

## Departamenti për Krime të Renda

Në Departamentin për Krime të Renda, do të punojnë 12 gjyqtarë:

1. Avni Syla;
2. Alltn Murseli;
3. Alban Ajvazi;
4. Naser Foniqi;
5. Fatime Dermaku;
6. Medie Bytyqi;
7. Agim Kuqi;
8. Gazmend Bahtiri;
9. Gezim Ademi;
10. Sulltane Hoti;
11. Ertan Sejfullahu;
12. Gent Beka;



## Departamenti për të Mitur

Në Departamentin për të Mitur do të punojnë 3 gjyqtar:

1. Adnan Isufi;
2. Elife Uka;
3. Lumnije Krasniqi;

## Departamenti Administrativ

Në Departamentin Administrative do të punojnë 9 gjyqtarë:

1. Luljeta Maxhuni;
2. Arjeta Sadiku;
3. Anita Nikqi – Morina;
4. Vjollca Limani;


5. Lirie Maksutaj;
6. Kreshnik Kaqiu;
7. Liridona Haziri – Kajtazi;
8. Valbona Gjonbalaj;
9. Rexhep Gashi;

## Departamenti i Përgjithshëm

Në Departamentin e Përgjithshëm, do të punojnë 42 gjyqtar të cilët janë të ndarë në tri divizionë:

### - Në Divisionin Civil do të punojnë 30 gjyqtar


1. Mevlide Kosumi – Qarri;
2. Bujar Doberdolani;
3. Lendita Berisha;
4. Fatbardha Uka-Ibrahim;
5. Hysni Ismajli;
6. Ilire Vitija;
7. Ujëvesa Hysenaj;
8. Perparim Zeka;
9. Nexhat Qallapeku;
10. Labinot Zeka ne studime në SHBA;
11. Donika Dobruna;
12. Rrezarta Sylejmani – Voca;
13. Valentina Sopjani;
14. Shpresa Veselaj;
15. Egzon Mujaj;
16. Kosovare Musliu – Prokshaj;
17. Dardan Hoxha;
18. Blerim Halimi;
19. Rrezarta Lleshaj;
20. Ibrahim Maloku;



21. Ermir Ahmetaj;
22. Greta Ibraj;
23. Rrezarta Ajeti;
24. Blerand Rrmoku;
25. Shefki Berisha;
26. Florian Krasniqi;
27. Argzon Muçaj;
28. Shaban Prekalla ( Trajnim fillestar AD)
29. Gentiana Shabani Haziri ( Trajnim fillestar AD)
30. Albana Ukshini ( Trajnim fillestar AD)

#### **Në Divizionin Penal do të punojnë 12 gjyqtar:**

1. Sabit Sadikaj;
2. Anita Krasniqi-Prenaj;
3. Adnan Kamberi në studime në SHBA;
4. Edita Çanta;
5. Naime Krasniqi Jashanica;
6. Donike Shala – Abdyli;
7. Eroll Gashi;
8. Dibran Jusufi;
9. Bujar Ahmeti;
10. Driton Berisha;
11. Fisnik Gashi ( Trajnim fillestar në AD)
12. Aferdita Prenaj ( Trajnim fillestar në AD)



#### **Në Divizionin e Kundërvajtjes do të punojnë 2 gjyqtar:**

1. Shaqir Mazreku;

2. Elheme Jashari;

Gjyqtarët gjatë vitit kalendarik 2024, mund të caktohen dhe ri-caktohen në departamente dhe divizione tjetër ndryshe nga sistematizimi i këtij plani, varësisht nga nevojat e gjykatës për të adresuar ngarkesën me lëndë, për të zvogëluar vonesat në kategoritë e caktuara të lëndëve dhe ngritur efikasitetin e gjykatës në përgjithësi.

Gjyqtarët që do të risistemohen nga një divizion në divisionin tjetër, do t'i mbajnë lëndët e divisionit të mëparshëm me të cilat kane qenë të ngarkuar, përvèç nëse shprehimisht vendoset ndryshe.

**Për udhëheqës të departamenteve dhe gjyqtar përgjegjës të divizioneve caktohen:**

- Valon Kurtaj - Udhëheqës i Departamentit Special ( me vendim të KGJK-së) ;
- Avni Syla – Udhëheqës i Departamentit të Krimeve të Renda;
- Adnan Isufi – Udhëheqës i Departamentit për të Mitur;
- Luljeta Maxhuni – Udhëheqës i Departamentit Administrativ;
- Ilire Vitija – Udhëheqës i Departamentit të Përgjithshëm dhe Gjyqtar përgjegjës i Divisionit Civil;
- Sabit Sadikaj – Gjyqtar përgjegjës në Divisionin Penal;
- Elheme Jashari – Gjyqtare përgjegjëse në Divisionin e Kundërvajtjes;

Në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe degë bëjnë pjesë edhe gjyqtarët porotë, të cilët në numër janë 34.

Në Gjykatën Themelore në Prishtinë janë të angazhuar 57 bashkëpunëtor profesional, 4 prej të cilave janë në pushim të lindjes, ndërsa 2 janë në studime jashtë vendit. Në degët e GJTHP-së janë të angazhuar 9 bashkëpunëtor profesional.

## Përbërja e Kolegjeve, ndarja e lëndëve dhe procedura paraprake

Në Departamentin Special, trupi gjykues përbehet nga tre gjyqtar profesional të njëjtët departamentit, me përjashtim në rastet e bartura nga Departamenti i Krimeve të Renda, në trupe gjykuese mund të caktohen edhe gjyqtar nga Departamenti i Krimeve të Renda.

Për shkak se sistemi automatik i përcaktimit te trupave gjykuese brenda Smil për momentin është jo funksional, anëtarët e trupave gjykuese caktohen nga Kryetarja e Gjykatës me vendim të veçantë, për secilën aktakuzë të pranuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, deri ne funksionalizimin e të njëjit.

Në Departamentin për Krime të Rënda, trupi gjykues përbëhet nga tre gjyqtar profesional të njëjtët departament, përjashtimisht mund te angazhohen edhe gjyqtaret nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal.

Për shkak se sistemi automatik i përcaktimit te trupave gjykuese brenda Smil për momentin është jo funksional, anëtaret e trupave gjykuese në DKR caktohen nga Kryetarja e Gjykatës me vendim të veçantë, sipas sistemit te kombinimit me radhe, për secilën aktakuzë të pranuar nga Prokuroria Themelore e Prishtinës, deri ne funksionalizimin e të njëjit.

Në Departamentin e Përgjithshëm, procedurat udhëhiqen nga gjyqtari i vetëm.

Në Departamentin për të Mitur trupi gjykues udhëhiqet konform Kodit të Drejtësisë për të Mitur, në rastet kur gjykohet nga trupe gjykuese, anëtar të trupit gjykues do të jenë gjyqtaret për të mitur, përjashtimisht mund të angazhohen gjyqtaret e Departamentit të Përgjithshëm, kur ka raste të përjashtimit të ndonjërit prej gjyqtareve.

Të gjitha çështjet në Departamentin e Përgjithshëm dhe Administrativ gjykohen nga një (1) gjyqtar i vetëm, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.

## Kolegjet Shqyruese

Kolegji shqyrtes përbehet prej tre (3) gjyqtarëve për të shqyrtuar dhe gjykuar një kundërshtim kundër urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake. Kryetari i gjykatës konform nenit 418 paragrafi

2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), cakton kolegjin shqyrtues prej tre (3) gjyqtarëve. Përbërja e njëjtë si tek Kolegjet Shqyrtues, shërben edhe për Panelin për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit, sipas nenit 98 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës se Kosovës.

Në rast të ndonjë pengese që ndonjëri nga gjyqtarët e caktuar në kolegj, të mos mund të ushtroj funksionin në çështje të caktuara, të njëjtit zëvendësohen nga gjyqtarët e tjera dhe po ashtu nga kryetari i gjykatës.

## Ndarja e lëndëve

Ndarja e lëndëve në punë tek secili gjyqtar bëhet nëpërmes shpërndarjes elektronike përmes Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve –SMIL. Lëndët e procedurës paraprake ndahen mbi baze të orarit mujor të kujdestarisë, duke i dhënë çdo herë përparësi ndarjes elektronike, në pamundësi teknike të aplikimit të kësaj ndarje do të aplikohet metoda manuale, ashtu siç është përcaktuar në Rregulloren për Veprimtarinë e Gjykatave. Nëse gjyqtarit të cilit i është caktuar lënda duhet përjashtuar nga arsyet e ndryshme, kërkesa për përjashtim duhet të bëhet përmes Sistemin për Menaxhimin e Lëndëve –SMIL.

## Procedura paraprake në penale

Të gjithë gjyqtaret e DS, DKR, DM dhe DP do të veprojnë edhe si gjyqtar të procedurës paraprake sipas një orari të përcaktuar më parë nga Udhëheqësi i Departamentit.

Gjyqtarët në procedurën paraprake duhet të jenë në gatishmëri të detyrës për një javë, mbi baza rotative dhe të barabarta. Në rast mungese të gjyqtarit kujdestar, zëvendësohet nga gjyqtari i cili është kujdestar sipas radhës së ardhshme vijuese.

Gjyqtaret e procedurës paraprake, të cilët kanë lëshuar Urdhëresa Gjyqësore për Masa të Fshehta do të vendosin edhe për kërkesat për sigurimin e te pandehurit, po ashtu gjyqtarët që kanë vendosur mbi kërkesat për sigurimin e prezencës së të pandehurit (paraburgim, arrest shtëpiak etj), do të vendosin edhe për Urdhëresat që lidhen me atë çështje penale dhe të gjitha kërkesat e tjera që kanë të bëjnë me atë lëndë, pavarësisht se të njëjtat mund të pranohen në javën që nuk janë kujdestar.

## Urdhrat Mbrojtës ne Civile

Të gjithë gjyqtaret e civiles do të ngarkohen me rastet nga mbrojtja e dhunës në familje Urdhrave Mbrojtës Emergjent sipas një orari një favor te caktuar nga Udhëheqësi i Divizionit Civil. Në rast mungese të gjyqtarit kujdestar, do të zëvendësohet nga gjyqtari i cili është kujdestar sipas radhës së ardhshme vijuese.

### III. Degët e Gjykatës

Degët e Gjykatës Themelore në Prishtinë janë: Dega në Fushë Kosovës, Dega në Podujeve, Lipjan, Graçanicë dhe Gllogoc, të cilat funksionin gjyqësor e kryejnë përmes Departamentit të Përgjithshëm, ndërsa secila degë e Gjykatës, ka edhe gjyqtarin mbikëqyrës dhe ndihmës administratorin, të cilët do të kujdesen për organizmin dhe mbarëvajtjen e punës brenda gjykatës së tyre.

#### Në degën e Gjykatës në Fushë Kosovë do të punojnë 5 gjyqtar:

1. Suzana Çerkini, Gjyqtare gjyqtare mbikëqyrëse ( lëmi penale),
2. Freskim Musliu, Gjyqtar në lëmine Civile,
3. Qendresa Beqiri, Gjyqtare në lëmine Civile,
4. Misare Murturi, Gjyqtar në lëmine Penale dhe Kundërvajtje,
5. Laura Hoti Statovci, Gjyqtare në lëmine Penale dhe Kundërvajtje ;

#### - Në degën e Gjykatës në Podujeve do të punojnë 7 gjyqtar:

1. Minir Hoti – Gjyqtar në Lëmin Penale dhe kundërvajtje, si dhe gjyqtar mbikëqyrës i degës,
2. Fatmir Aliu –Gjyqtare në lëmine Civile,
3. Binak Duqi – Gjyqtar në lëmin Civile
4. Asdren Hasani, Gjyqtar në lëmin Civile
5. Nazmi Neziri – Gjyqtar në lëmin Civile,
6. Artan Fazliu- Gjyqtar në lëmin Civile,
7. Besnik Sheqiri – Gjyqtar në lëmine Penale dhe kundërvajtje,
8. Adelina Jusufi – Gjyqtar në lëmin civile ( Deri ne muajin Maj, gjendet ne trajnim fillestar në Akademinë e Drejtësisë)

- **Në Degën e Gjykatës në Lipjan do të punojnë 7 gjyqtar:**

1. Zenel Tasholli – Gjyqtar mbikëqyrës - Gjyqtar në lëmin Civile,
2. Isa Gashi – Gjyqtar në lëmine Civile,
3. Elvira Emini – Gjyqtare në lëmine Civile,
4. Filloreta Lekiqi – Gjyqtare në lëmine Civile,
5. Avdurrahman Gashi – Gjyqtar në lëmine Penale,
6. Selman Salihi – Gjyqtar në lëminë Penale
7. Besim Kolshi – Gjyqtar në lëmin për Kundërvajtje

- **Në Degën e Gjykatës në Gllogoc do të punojnë 5 gjyqtar:**

1. Shefqet Baleci – Gjyqtar në lëmin Penale dhe gjyqtarë mbikëqyrës i degës,
2. Jeton Krasniqi – Gjyqtare në lëmin Civile,
3. Astrit Gashi – Gjyqtar në lëmin Civile,
4. Kaltrina Emini Haxhiu – Gjyqtare në lëmine Civile,
5. Vesel Gorani – Gjyqtar në lëmin për Kundërvajtje dhe gjyqtar i procedurës paraprake ne penale.

- **Në Degën e Gjykatës në Graqanicë do të punojnë 4 gjyqtar:**

1. Sinisa Borisavlevic – Gjyqtar në lëmin Penale si dhe gjyqtar mbikëqyrës i degës,
2. Liljana Maksimovic – Gjyqtar në lëmin Civile,
3. Jovica Mitroviç – Gjyqtar në lëmine Civile,
4. Rrustem Begolli – Gjyqtar në lëmin për Kundërvajtje – Penale.

#### **IV. Ndihma Juridike Ndërkombëtare**

Kryetarja e Gjykatës Themelore, vendos në çdo rast kur kërcohët ndihma juridike ndërkombëtare përveç kur për kërkësë duhet të vendos kolegji si dhe për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja, të cilat vendosen nga gjyqtarët e divizionit civil, varësisht nga shpërndarja e lëndëve përmes sistemit SMIL.

## V. Caktimi i shqyrtimave gjyqësore dhe publikimi i orarit të mbajtjes së tyre

Shqyrtimet gjyqësore caktohen nga gjyqtarët, përkatësisht kryetarët e trupave gjykuese konform dispozitive të KPPRK-së dhe LPK-së. Orari i seancave gjyqësore regjistrohet në SMIL dhe publikohen në portalin gjyqësor.

## VI. Mbledhjet e kolegjiumit të gjithë gjyqtarëve, departamenteve dhe divizioneve

Së paku një (1) herë në (3) muaj do të mbahet mbledhje e kolegjiumit të gjyqtarëve sipas Departamenteve me Kryetaren e Gjykatës, ndërsa së paku (1) herë në muaj, do të mbahet mbledhje e gjyqtarëve të departamenteve dhe të divizioneve përkatëse te udhëhequra nga Mbikëqyrësi i Departamentit.

Sipas nevojës mbledhjet e kolegjumet mund të thirren në çdo kohë.

Kryetari i gjykatës thërret kolegjumin e gjyqtareve në gjykate për të diskutuar lidhur me administrimin e gjykatës, për të shqyrtuar organizimin e punës, rezultatet e arritura në gjykate dhe për t'i trajtuar problemet dhe sfidat e punës.

Pjesëmarrja në kolegjume dhe mbledhjet e departamenteve dhe divizione, është e obligueshme.

Kolegjumi i gjyqtareve, në mbledhjet e tij nxjerre edhe rekomandime te cilat duhet të përfillejn nga kryetari i gjykatës, nënkryetari, gjyqtari mbikëqyrës, stafi gjyqësor dhe stafi administrativ. Rendi i ditës për mbledhjen e kolegjiumit të gjyqtarëve duhet te përcaktohet nga kryetari i gjykatës.

Administratori mbështet kryetarin e gjykatës në organizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të kolegjiumit të gjyqtareve, i cili njofton gjyqtaret të paktën shtatëdhjetedy (72) orë para mbledhjes, furnizon gjyqtarët me materialet e rëndësishme të mbledhjes, dhe mban procesverbalin përrjedhën e mbledhjes, të cilat procesverbale paraprakisht iu dorëzohen gjyqtarëve të gjykatës, përtë paraqitur vërejtjet e tyre eventuale, pastaj miratohen në kolegjumin e radhës. Të gjitha dokumentet e takimeve të kolegjiumit të gjykatës duhet të arkivohen në dosje të veçanta

## VII. Orari i Punës dhe Respektimi i Kodit të Mirësjelljes

Orari i punës në gjykatë fillon në ora 08:00 dhe zgjat deri në ora 16:00, ndërsa pushimi ditor shfrytëzohet nga ora 12:00 deri në ora 13:00, në rast pamundësie të shfrytëzimit të pushimit brenda këtij orari, pushimi ditor mund të shfrytëzohet edhe jashtë këtij orari, por vetëm për të njëjtën ditë.

Të gjithë të punësuarit në Gjykatën Themelore në Prishtinë, janë të obliguar që gjatë orarit të punës në ushtrimin e pozitës zyrtare, të sillen në mënyrë korrekte, duke respektuar Kodin e Mirësjelljes për Personelin e Administratës Gjyqësore, njëkohësisht Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Veshja dhe paraqitja e të gjithë zyrtarëve të gjykatës, duhet të jenë serioze, për ta përfaqësuar sa më denjësisht institucionin në pajtim me legjislacionin në fuqi.

### **VIII. Trupa për Menaxhimin e Krizave**

Trupa Menaxhue e Krizave e Gjykatës Themelore në Prishtine, i themeluar sipas Planit të Veprimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Menaxhimin e Krizave, bazuar në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK) pas situatës së krijuar nga pandemia Covid 19, do të vazhdojë funksionin e saj edhe gjatë vitit 2024, varësisht prej gjendjes së krijuar me pandeminë do të jetë përgjegjëse që të siguroje mbarëvajtjen e punës së gjykatës, duke iu përshtatur rrethanave emergjente dhe në përputhshmëri me vendimet e institucioneve relevante.

Trupa Menaxhue e Krizave, përbëhet nga: Kryetarja e Gjykatës – Udhëheqës i Trupës Menaxhue, Gjyqtarët Mbikëqyrës të Degëve dhe Administratori i Gjykatës

Trupa Menaxhue planifikon, organizon dhe siguron mbarëvajtjen e punës në Gjykatë, përfshirë caktimin e llojit të shërbimeve të gjykatës, vëllimit të punës së gjyqtareve dhe stafit administrativ, orarin e punës, marrjen e masave mbrojtëse, dhe vendime të tjera në pajtim me vendimet e KGJK-së .

Trupi për Menaxhimin e Krizave të Gjykatës Themelore në Prishtine do të shërbeje edhe në raste dhe situatat e tjera emergjente shëndetësore, katastrofat natyrore, kërcënimeve të sigurisë apo rrethana të tjera të natyrave të ngjashme edhe në të ardhmen.

### **IX. Komisioni Administrativ i Gjykatës Themelore**

Komisioni Administrativ i gjykatës në përbërje nga kryesues – Kryetarja e Gjykatës Themelore dhe Gjyqtaret Mbikëqyrës nga Degët, ndërsa sekretar i komisionit menaxhue është administratori i gjykatës. Komisioni Administrativ takohet rregullisht dhe jo më pak se katër (4) herë gjatë

vitit me ftesë nga Kryetarja e Gjykatës, për të vlerësuar punën e gjykatës dhe ndërmarrjen e veprimeve riparuese në përputhje me rregullat dhe udhëzimet që janë të nevojshme për përmirësimin e veprimeve administrative të gjykatës.

## X. Implementimi i programit TIK/SMIL

Gjykata Themelore në Prishtine së bashku me dege do të vazhdoj me implementimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (TIK/SMIL), i cili ka treguar sukses dhe rritjen e efikasitetit dhe transparencës së gjykatës. Edhe në vitin 2024 raportet e të gjithë gjyqtarëve do të nxjerrën vetëm përmes sistemit SMIL, përfshirë këtu edhe raportet e përgjithshme të gjykatës, të gjitha aktakuzat e prokurorisë së shtetit do të pranohen përmes SMIL, po ashtu orari i seancave gjyqësore për publikim në ueb faqen e gjyqësorit do të jetë i lidhur direkt me SMIL.

## XI. Transparenca dhe llogaridhënia

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënieς, gjykata do të informojë publikun rregullisht mbi punën dhe aktivitetet e gjykatës. Publiku në baza ditore do të kenë qasje në orarin e seancave gjyqësore të çështjeve penale, civile apo të kundërvajtjes i cili do të publikohet në ueb faqen e gjykatës. Po ashtu publiku do të ketë qasje në statistikat e gjykatës, raportet e punës, statistikat e përformancës së gjykatës, plani dhe programi vjetor i punës do të jenë të çastshme për të gjithë, me çka publikut do t'i mundësohet qasje e gjerë në aktivitetet e gjykatës, për të cilat publiku njëkohësisht do të mund të informohet edhe përmes rrjetit social facebook.

Web faqja e gjykatës po ashtu ofron mundësinë edhe për kërkimin e Statusit të Lëndës dhe njëkohësisht aplikimin online e qytetarëve për certifikatën e personave kundër të cilëve është zhvilluar apo është duke u zhvilluar procedurë penale.

Në anën tjeter të gjitha aktgjykimet e formës së prerë të çështjeve penale dhe civile, do të publikohen në ueb portalin gjyqësor të Republikës së Kosovës, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së për Anonimi imin dhe Publikimin e Aktgjykimeve dhe Aktvendimeve.

Te gjitha Organizatat Joqeveritare, monitoruesit dhe mediat te cilat kane te nënshkruara memorandume te bashkëpunimit me KGJK, apo ne forma te tjera shprehin interesim qe te

monitorojnë seancat gjyqësore, do t'i u mundësohet përcjellja e seancave gjyqësore konform rregullave te parapara me ligjet ne fuqi, përpos rasteve ne te cilat publiciteti ndalohet apo është i kufizuar me ligj.

## XII. Efikasiteti dhe Prioritizimi i lëndëve brenda sistemit gjyqësor bazuar në Planin Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2023-2025

Kryetari i Gjykatës do të sigurojë mbikëqyrje të përditshme gjyqësore dhe menaxheriale në zbatimin e planit strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi. Qëllimi i këtij plani strategjik është paraqitja e një vizioni të përgjithshëm strategjik për adresimin dhe zgjidhjen e lëndëve të cilat janë me prioritet, përfshirë lëndët që janë kthyer në rigjykim, lëndët të cilat janë të prioritetit të lartë në bazë të ligjeve përkatëse, lëndët të vilat janë punuar në gjykata dhe ka kaluar dy vite për të cilat nuk ka filluar trajtimi i tyre, si dhe lëndët e tjera për të cilat duhet ndërmarrë veprime të përshpejtuara.

## XIII. Planit Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korruptionit dhe krimtit të organizuar 2022 – 2024

Kryetari i Gjykatës do të sigurojë mbikëqyrje të përditshme gjyqësore dhe menaxheriale në zbatimin e Planit Strategjik për trajtimin me prioritet dhe zgjidhjen efikase të lëndëve të korruptionit dhe krimtit të organizuar. Sipas kërkesave të këtij plani, Kryetari i Gjykatës do të mbledh informata nga gjyqtarët që trajtojnë këto raste dhe në baza mujore do të raportoj lidhur me statusin e lëndëve te Kryetari i Komisionit për Vlerësimin dhe Raportimin e këtij plani.

## XIV. Komunikimi me Institucionet veprimtaria e të cilave ka ndikim në veprimtarinë e gjykatës

Gjykata do të mbaj komunikim mbi baza të rregullta dhe të vazhdueshme me institucionet veprimtaria e të cilave ndikon në punën e gjykatës.

Bashkëpunimi me policinë sidomos në çështjet e ekzekutimit të urdhëresave, do të monitorohet mbi baza mujore dhe do të këtë takime të rregullta me drejtues të policisë përkitazi me ecurinë e

zbatimit të urdhëresave. Gjithashtu me njësinë për sjelljen e personave të paraburgosur do të ketë koordinim të duhur në mënyrë që mos të ketë dështim apo vonesa të seancave të caktuara.

Planifikohen takime edhe me drejtues të institucioneve tjera si Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Prokurorinë Speciale, Oden e Avokateve, Akademinë e Drejtësisë, Shërbimi Korrektues, Shërbimi Sprovues, etj, në funksion të ngritjes së efikasitetit të punës së Gjykatës dhe evitimit të pengesave të mundshme.

Bashkëpunimi me programin OPDAT, Ambasada Amerikane dhe GJTHP Prishtinë konkretisht Departamentin Special, do te vazhdoj edhe këtë vit me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe përmirësimit të cilësisë se vendimeve. Bashkëpunimi me USAID, OSBE, KeE, EULEX, si dhe organizatat tjera ndërkombëtare si dhe vendore joqeveritare dhe qeveritare do të vazhdoj edhe në vitin 2024.

## XV. Koordinatoret e dhunës në familje

Bazuar në nevojat qe dalin nga planet strategjike, Kryetarja e gjykatës cakton edhe dy koordinator për rastet e dhunës në familje për vitin 2024:

Koordinator për rastet e dhunës ne familje në lëmin penale Donika Shala Abdyli

Koordinator për rastet e dhunës ne familje në lëmine civile Ilire Vitija

## *Programi për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve*

### Prioritetet e Departamenteve të Gjykatës dhe rekomandimet për vitin 2024

#### Departmenti Special

##### **Prioritetet e DS-së :**

Prioriteti e DS-së do të jetë përmbushja e planit te veçanta të punës, në të cilin do të prioritizohen lëndët të cilat do të përfundojnë brenda vitit 2024 (detajet tjera planit i bashkangjitur).

Konfiskimit dhe sekuestrimit, do t'i kushtohet vëmendje e veçantë, në të gjitha rastet kur plotësohen kushtet ligjore të shqiptohen masat për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale, pasi që në këtë mënyrë do të dekurajohen kryesit potencial dhe do të dërgohet mesazh i qartë se përfitimet e paligjshme nuk mund ti gëzon askush që i ka fituar në këtë mënyrë.

#### Departamenti për Krime të Rënda (DKR)

##### **Prioritetet e DKR-së**

Prioritet i DKR-së do të jetë kryerja e lëndëve që kanë të bëjnë me veprat penale kundër detyrës zyrtare (me natyrë korrupzioni), krimit të organizuar dhe veprave penale të dhunshme dhe me pasoja të rënda siç janë vrasjet, grabitjet etj. Për të njëjtat duhet të ndërmerrin të gjitha masat e mundshme ligjore që të përfundohen sa më shpejt. Lëndët e kthyera në rivendosje do të caktohen dhe përfundohen sipas afateve ligjore që përcaktohen për lëndët e tillë.

Konfiskimit dhe sekuestrimit, do t'i kushtohet vëmendje e veçantë, ( shih te prioriteti i caktuar te DS).

##### **Rekomandimet për këtë vit për DS dhe DKR:**

Të aplikohet mbajta e seanca ne mënyrë të vazhdueshme, duke bërë planifikim dhe caktimi të seancave të njëpasnjëshme për rastet e komplikuara;

Të eliminohen shtyrjet e panevojshme të seancave;

Të shkurtohet numri i seancave gjyqësore për ta përfunduar çështjen (përkundër faktit se natyra e çështjeve është më komplekse dhe serioze, numri i seancave të planifikuara duhet të jetë racional, i arsyeshëm dhe jo i tepruar);

Të ketë një klasifikim të diferencuar të lëndëve si p.sh: komplekse, standarde dhe të thjeshta si dhe klasifikim në bazë të prioriteteve sipas strategjive të KGJK-së dhe varësisht nga ky klasifikim të planifikohet përfundimi i tyre;

Gjyqtaret duhet ti japid përparësi rasteve të profilit të larte dhe ti shmangin vonesat e panevojshme;

Aplikimi i Udhëzuesve për politikë ndëshkimore;

## Departamenti për të Mitur (DM)

### Prioritetet e DM-së

Prioritet i DM-së do të vazhdon të jetë përfundimi i të gjitha lëndëve të cilat bien në kompetencë të këtij departamenti, duhet të ndërmerrën me kohë dhe pa vonesa të gjitha masat e mundshme ligjore që lëndët të përfundohen sa më shpejt.

Lëndët e kthyera në rivendosje do të caktohen dhe përfundohen sipas afateve ligjore që përcaktohen për lëndët e tillë.

#### Rekomandimet për këtë vit:

- a) Të eliminohen shtyrjet e panevojshme;
- b) Të përfundohen lëndët që janë në kompetencë të Departamentit për të Mitur, brenda një afati të arsyeshëm ashtu siç parashihen në Kodin e Drejtësisë për të Mitur ;

## Departamenti Përgjithshëm/Divizioni Penal ( DP )

Prioritet e DP-së, do të janë trajtimi i rasteve të dhunës në familje, ndalimi i parashkrimeve, rritja e efikasitetit duke përfunduar me shumë lëndë, të eliminohen shtyrjet e panevojshme të seancave, të caktohen seancat me kohe, të eliminohen pengesat e shtyrjes së seancave para fillimit të njëjtës.

#### Rekomandimet :

- c) Të aplikohet standardi i organizmit të punës brenda zyrës së gjyqtareve që lëndët të ndahen: në të thjeshta ( të cilat mundtë kryhen me angazhim minimal të gjyqtarit siç mund të jenë urdhrat ndëshkimor, lëndët me pranim të fajësisë, lëndët e vendosura jashtë shqyrtimit gjyqësor);
- d) Lëndët standarde (lëndët tipike që kryhen me angazhimin normal të gjyqtarëve që kërkon mbajtjen e seancave, dëgjimin e dëshmitarëve, të pandehurit, administrimin e provave), lëndë të komplikuara ( ku përfshihen lëndët me numër të madh të pandehurve, disa vepra, numër i madh i dëshmitarëve);
- e) Planifikimi me i mirë sa i përket caktimit të lëndëve, duke i identifikuar lëndët në të cilat ka gjasa reale apo në bazë të deklarimeve të mëparshme është e pritshme pranimi i fajësisë. Si rezultat i saj caktimi i një numri më të madh të tyre brenda një dite, pasi që kur të pandehurit pranojnë fajësinë mund të përfundohen shpejt;
- f) Të bëhen përpjekje që lëndët të përfundohen brenda një seance dhe kjo të jetë një rregull, ndërsa shtyrjet të jenë një përjashtim dhe të bëhen vetëm mbi bazat e propozimeve të justifikueshme të cilat thelbësishtë i kontribuojnë çështjes. Në këtë mënyrë pretendohet të eliminohet kultura e shtyrjeve të panevojshme;
- g) Politika ndëshkimore duhet të rishikohet veçanërisht tek disa vepra të cilat për nga natyra dhe shtrirja e tyre meritojnë që kryesve të tyre të ju shqiptohen dëname më të ashpra.
- h) Të referohen sa më shumë raste në procedurën alternative
- i) Rrjedhimisht, numri i përgjithshëm i lëndëve që mund të përfundohen brenda një muaji kalendarik nga gjyqtarët e këtij departamenti, duhet të jetë i lartë, pasi kjo mund të arrihet me angazhim dhe përpjekje normale, me një qasje praktike e kombinuar me shkathtësi mesatare menaxheriale, njëkohësisht pa e dëmtuar kualitetin e vendimeve dhe procesit në përgjithësi.

Divizioni Civil (DC)

Prioritet i Divisionit Civil do të jenë trajtimi me kohe i lendeve të cilat ligji iu jep prioritet, lëndëve të vjetra dhe lendeve të kthyera në rigjykim.

Procedura civile duhet të thjeshtësohet, të bëhet më fleksibile dhe më e shpejtë, derisa në të njëjtën kohë të mbahen garacionet e ofruara për palët, përmes rregullave dhe procedurave ligjore. Në mënyrë që të arrihen këto synime, është e nevojshme që palëve t'u vihen në dispozicion forma më të thjeshtësuara, dhe më të shpejta të procedimeve duke i mbrojtur nga vonesa të paarsyeshme, në këtë kontekst veçanërisht është e rëndësishme që gjyqtarët duhet drejtuar seancat në mënyrë më efektive.

Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet strukturës së lëndëve të kryera, në mënyrë që mos të dominojnë lëndët e natyrës së lehtë, të zgjidhen lëndët që kanë konteste reale sidomos atyre që kanë të bëjnë me pronësinë dhe raportet mes palëve kontestuese të cilat janë të acaruara, përkatesisht kontestet reale, në të cilën qytetaret kanë problemet më të mëdha dhe për kohë të gjatë presin drejtësi.

*Rekomandimet :*

Aplikimi i dispozitave ligjore të cilat racionalizojnë procedurën siç janë: marrëveshjet gjyqësore, aktgjykimet për shkak të pohimit, për shkak të mos bindjes, për shkak të mungesës, aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes po që se i padituri në përgjigje në padi ka pohuar faktet vendimtare përkundër kontestimit të kërkesëpadisë e cila autorizon gjykatën që të jap aktgjykin pa caktuar seancë gjyqësore nëse nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e tij - neni 152 i LPK-së;

Të vendoset standard që të gjitha ato lëndë përshirë edhe ato të cilat sapo janë regjistruar të vlerësohet përshtatshmëria për ndërmjetësim, dhe nëse vlerësohen se i plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë të referohen në këtë procedurë pa vonesa;

Paditë të pranuara pa vonesa të i' u dërgohen të paditurve për përgjigje në padi, në këtë drejtim të angazhohen bashkëpunëtorët profesional për të asistuar gjyqtarët;

Vendosja e shpejt dhe brenda standardeve ligjore të lëndëve që janë kthyer në rivendosje nga Gjykata e Apelit dhe eventualisht nga Gjykata Supreme;

Të vendosen sanksione kur njëra palë e cila është njoftuar për hapin e mëtejmë nuk ndërmerr hapin procedural brenda afateve kohore të caktuara nga ligji apo gjykata. Gjykata duhet të jetë në gjendje që të zbatoj sanksione të përshtatshme në rast të mospjesëmarrjes së paarsyetur të

dëshmitarëve apo palëve në procedurë. Në rast se eksperti i emëruar nga gjykata dështon të paraqes raportin e tij apo reporti është i vonuar pa arsyetim të mirë, atëherë duhet të zbatohen sanksione të përshtatshme;

Gjykata gjatë seancës përgatitore, por nëse është e mundur gjatë gjithë seancave të luaj një rol aktiv për të siguruar progres të shpejt të seancave dhe që ndërkojë respekton të drejtat e palëve. Në veçanti duhet të ketë autoritet për të urdhëruar palët që të ofrojnë sqarimet e nevojshme, të përjashtohen dëshmitarët dëshmia e të cilëve do të ishte e parëndësishme për lëndën në fjalë, për të kufizuar numrin e dëshmitarëve për një fakt të caktuar kur një numéri tillë do të ishte i tepruar;

Në lëndët përmbarimore, të ndërmerren veprime të menjëhershme për përfundimin e lëndëve të vjetra, kthimi i punëtorëve në punë, ekzekutimet me vlera të larta si dhe të standardizohet ekzekutimi përmes rrugëve bankare si mënyrë më e përshtatshme, më e sigurt dhe e cila do të sjellë më shumë rezultate.

Të behet specializimi i gjyqtareve për procedura te veçanta siç janë procedura përmbarimore, jo kontestimore dhe familjare.

Gjyqtaret ne çdo fazë dhe gjate trajtimit te lendeve duhet te bëjnë përpjekje qe te aplikojnë procedurat e zgjidhjes alternative te mosmarrëveshjeve, ne veçanti të tentohet zgjidhja e çështjeve përmes procedurës se ndërmjetësimit. Ne të gjitha kategoritë e rasteve civile kur me Ligj parashihet referimi i rastit ne ndërmjetësim, gjyqtaret kane për obligim te zbatojnë ketë procedure. Po ashtu, gjyqtaret duhet te kenë prioritet dhe të aplikojnë referimin e lendeve të përshtatshme për ndërmjetësim.

## Divizioni për Kundërvajtje

### Përshkrimi

Në këtë divizion punojnë dy (2) gjyqtar, të cilët duhet të angazhohen që të përfundojnë sa më shpejtë këto procedura dhe të ndërpresin parashkrimin në çdo lende.

### Rekomandimet:

Të përfundohet numër sa më i lartë i lëndëve, në mënyrë që të krijohet kultura e respektimit të ligjit dhe të pengohet maksimalisht parashkrimi i lëndëve;

## Përfundimi

Si përfundim, presim që viti 2024 të jetë vit i suksesshëm si në aspektin e përfundimit të lëndëve, efikasitetit të gjyqtarëve, por edhe administratës në përgjithësi. Vonesat në trajtimin e lëndëve duhet ti takojnë të kaluarës, aplikimi i zgjidhjeve alternative të lëndëve si penale ashtu edhe ato civile - ndërmjetësimi, marrëveshja për pranimin e fajësisë, urdhrat ndëshkimore, racionalizimin e seancave tek rastet jo të komplikuara, aplikimi i seancave të njëpasnjëshme është e nevojshme që të avancohen në praktika përditshmërie të zgjidhjes së çështjeve gjyqësore.


Vëmendje e posaçme do të i kushtohet lëndëve që janë në rigjykimi dhe lëndëve më të vjetra se 24 muaj, pasi pikërisht te këto lëndë ekzistojnë vonesa, që duhet sa më parë të eliminohen dhe çështjeve të i'u hapet rrugadrejtë epilogut përfundimtar. Është synuar që gjykata të jetë aktive në procedimin e çështjeve duke e minimizuar kohën pasive të lëndës, ashtu që edhe këtë vit do të angazhohemi në kontrollin paraprak të padive në kohën sa më të shkurtë, në mënyrë që të identifikohen lëndët të cilat mund të përfundohen në këtë fazë apo edhe të eliminimit të mangësive në periudhën sa më të hershme tëprocedimit të tyre.

Prioritet i rëndësisë së veçantë do të ju jepet lëndëve të shenjëstruara, krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ky plan dhe program mund të ndryshohet dhe plotësohet nga kryetarja e gjykatës varësisht nga nevojat për organizimin më efektiv të punëve, zgjidhjen më efikase të lëndëve dhe në rast të ndryshimit të numrit të gjyqtarëve dhe strukturës së gjykatës.

Ky plan i punës dhe programi për zgjidhjen efikase të lëndëve, zbatohet nga 1 janar 2024.

Datë: 21 dhjetor 2023

Albina Shabani Rama  
  
Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë